



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës Opština Podujevo Municipality of Podujeva



DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT EKONOMIK

- *Procesverbal i takimit me biznese në kuadër të Diskutimit Publik në lidhje me Draft Rregulloren për Orarin e Punës së Bizneseve që Operojnë në Territorin e Komunës së Podujevës*

Të hënën, më 22/08/2022 duke filluar nga ora 10:00 në Sallën e Kuvendit Komunal të Komunës së Podujevës u mbajt diskutimi publik më biznese lidhur me Propozim Rregulloren për orarin e punës së bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Të pranishëm në takim ishin Drejtori i DPZHE, z.Vigan Salihu, Drejtoresha e DA, znj.Antoneta Ejupi dhe përfaqësues të bizneseve që operojnë në territorin e Komunës së Podujevës.

Takimin e hapi drejtori z.Vigan Salihu, ku kërkoj nga të pranishmit që t'i prezantojnë të gjitha mendimet dhe propozimet që ata kanë lidhur më Draft Rregulloren në fjalë.

Shefki Zeqiri, përfaqësues i biznesit AMI Center në Gërdoc, tha se duhet me shiku se cila është kostoja financiare e zbatimit të kësaj rregulloreje? Sipas tij, kjo rregullore i dëmton bizneset në masë të madhe nëse nuk ju lejohet të punojnë të dielave, sidomos Zonën e Orllanit.

Nga ana tjetër, Sabedin Buqa, përfaqësues i biznesit "Metro" tha se i përfaqëson shumicën e bizneseve, të cilët janë të mendimit që pjesa e Orllanit dhe pjesa e Kërpimehit të punojnë të dielave pasi këto dy pjesë e shfrytëzojnë për turizëm vikendin. "Fshatrat tjera dhe pjesa e qytetit të mos punojnë" tha Buqa.

Kurse, Rexhep Zeka, përfaqësues i biznesit, Market "Arlindi" në Orllan, tha se atyre u'a vështirëson punën kjo rregullore, sepse ata varen nga sezona dhe të dielat. "Në emër të atyre

tri lokaleve që janë atje, ne jemi për me punu të dielave. Nuk mendoj që duhet të përfshihet në rregullore pjesa e Orllanit për mos me punu. Mundeni me na e caktu një ditë tjetër ditë pushimi, por jo të dielën”, ka thënë Zeka.

Drejtori z.Vigan Salihu, u'a bëri më dije të pranishmëve që në këtë rregullore kanë punuar një grup punues, të cilët janë përfaqësues të të gjitha partive, dhe se do të organizohet debati publik edhe me qytetarë dhe mendimi i shumicës do të shkojë në Kuvend. Pastaj, shohim si vendos Kuvendi, ka thënë Salihu.

Në fund të takimit, shumica u pajtuan për propozimin që pjesa e Orllanit dhe Kërpimehit të punojë edhe të dielave, të tjerët jo.

NR: 15-300/01-0074961/22

Data:

22/08/2022

Mbajtësi i procesverbalit:

Mimozë Restelica Sejdiu





